

VENDIM
Nr. 79, datë 31.5.2019

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-s NR. 67, DATË 27.7.2011 PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“DOSKU-ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4, germa “a”, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurës Administrative”, si dhe 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi “Një ndryshim në vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011 për licencimin e shoqërisë “Dosku–Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 67, datë 27.7.2011, ka vendosur si më poshtë:

1. Licencimin e shoqërisë “Dosku–Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentralet “Gizavesh”, me kusht që: subjekti “Dosku Energji” sh.p.k. të paraqesë certifikatën e regjistrimit të pronësisë brenda 2 (dy) vjetësh nga data e dhënies së licencës.

2. Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.

- ERE ka evidentuar kushtin e vendimit të licencimit nr. 67, datë 27.7.2011 dhe ka kërkuar nga ana e shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 691 prot., datë 1.12.2015, e duke vijuar me shkresën nr. 61 prot., datë 13.1.2016 informacion mbi statusin e plotësimit të këtij kushti.

- Shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 61/1, datë 9.2.2016, ka bërë me dije statusin e plotësimit të kushtit duke sqaruar se Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka kthyer akoma pronën e njohur me vendim gjykatë të formës së prerë me arsyetimin se ka një vakum ligjor në funksionimin e këtij komisioni.

- Në vijim të problematikës për saktësimet përkatëse mes shoqërive “Dardania” sh.p.k. dhe “Dosku Energy” sh.p.k. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 5051/1 Prot., datë 11.8.2017, ka komunikuar në ERE ngritjen e një grupi pune për shkak të rëndësisë së problematikave të evidentuara rishtazi në procedurën e ndërtimit me koncesion të formës BOO (ndërtim, shfrytëzim, pronësi), të HEC-it Gizavesh. Në këtë korrespondencë, MIE-ja thekson se, nëpërmjet grupit të punës do të shqyrtojë gjithë dokumentacionin e kësaj procedure dhe në përfundim të shqyrtimit do të bëjë me dije ERE-n lidhur me vendimin e saj.

- Në vijim të sa më sipër, ERE ka pezulluar veprimet lidhur me këtë çështje duke qëndruar në pritje të një konkluzioni të grupit të punës së MIE-s.

- Shoqëria “Dosku–Energy” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 203, datë 5.3.2019 dhe nr. 203/3, datë 3.4.2019, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë duke kërkuar një vendimmarje nga ERE.

- Certifikatën e regjistrimit të pronësisë datë 30.7.2018, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme për zonën kadastrale nr. 1715, nr. pasurie 527–N Gizavesh – Librazhd, të shoqëruara me kartelën e pasurisë dhe planvendosjen përkatëse, e cila përkon me zonën ku shtrihet projekti i HEC-it.

Sa më sipër, rezulton se shoqëria “Dosku–Energy” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011, si më poshtë:

Licencimin e shoqërisë "Dokun-Energy" sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali "Gizavesb", me kapacitet të instaluar 0.5 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti